



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Drejtoria e Komisioneve dhe Materialeve Zgjedhore

Data	
Nr. Prot	

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN
PËR
CAKTIMIN E NJËSIVE ADMINISTRATIVE KU DO TË KRIJOHEN SELITË E KOMISIONEVE TË ZONAVE
TË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS
14 MAJ 2023

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Referuar nenit 19, pika 1, shkronjat “b” e “n”, të Kodit Zgjedhor parashikohen kompetencat e Komisionerit për të drejtuar dhe mbikëqyrur, drejtpërdrejt ose nëpërmjet administratës së KQZ-së, veprimtarinë e administratës zgjedhore përgjatë zgjedhjeve dhe referendumëve, si dhe për të ushtruar në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Referuar nenit 93 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet krijimi i selive të KZAZ-ve, sipas kriterëve të përcaktuara të këtij neni.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Komisioni Rregullator, me vendimin nr. 6, datë 30.11.2020 “Për miratimin e ngritjes së Zonave të Administrimit Zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 prill 2021”, miratoi ngritjen e 92 (nëntëdhjetë e dy) Zonave të Administrimit Zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 prill 2021.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 32, datë 16.12.2020 “Për caktimin e njësive administrative ku do të krijohen selitë e KZAZ-ve për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”, si dhe vendimin nr. 13, datë 25.01.2021 “Për disa ndryshime në vendimin e KSHZ-së nr. 32, datë 16.12.2020 ‘Për caktimin e njësive administrative ku do të krijohen selitë e KZAZ-ve për zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 prill 2021’”, vendosi caktimin e selive të KZAZ-ve për 92 zonat e administrimit zgjedhor duke u bazuar në:

- shtrirjen dhe relievin gjeografik të Zonave të Administrimit Zgjedhor;
- numrin dhe pozicionin gjeografik të njësive administrative të përfshira në territorin e Zonave të Administrimit zgjedhor;
- lehtësitë logjistike të transportit rrugor;
- praktikat e zgjedhjeve të mëparshme.



Në kushtet kur numri dhe territori i Zonave të Administrimit Zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, janë po ato të miratuara me vendimin e KSHZ-së nr. 32, datë 16.12.2020, rrjedhimisht selitë e KZAZ-ve do të krijohen në të njëjtat njësi administrative sikundër në zgjedhjet e 2021.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 3762, datë 25.11.2022, i është drejtuar bashkive për caktimin e ambientit që do të shërbejë si seli e KZAZ-së për zgjedhjet e datës 14 maj 2023. Kryetarët e bashkive në vijim kanë propozuar ambientet që do të shërbejnë për seli të KZAZ-së duke referuar adresën, ambientin dhe sipërfaqen.

Për sa më sipër në këtë relacion, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, i paraqitet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi "Për caktimin e njësive administrative ku do të krijohen selitë e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023".

Erion META Drejtorja e Administratës Zgjedhore
Majlinda ÇELMETA Drejtorja e Përgjithshme e Administrimit të Zgjedhjeve
Ylli MERKAJ Sekretar i Përgjithshëm



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data:2.2023

Nr:

Ora:

PROJEKTVENDIM

PËR

CAKTIMIN E NJËSIVE ADMINISTRATIVE KU DO TË KRIJOHEN SELITË E KOMISIONEVE TË ZONAVE TË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronjat “b” dhe “n”, e 2, dhe nenit 93, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, selitë e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor do të krijohen në njësitë administrative, sipas përcaktimeve në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Kryetarët e bashkive do të sigurojnë infrastrukturën logjistike në selitë e Komisioneve Zonale të Administrimit Zgjedhor.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: .2.2023 Nr:
Ora:



“Për caktimin e njësive administrative ku do të krijohen selitë e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”

Qarku	Bashkia	Njësia Administrative	ZAZ	Vendndodhja e Selisë ZAZ/Qendra e Njësisë Administrative	Selia e KZAZ-së 2023			
Shkodër	MALËSI E MADHE	Koplik	01	Koplik	Qendra Kulturore e Fëmijëve, Koplik i Sipërm			
		Gruemirë						
		Kastrat						
		Kelmend						
		Qendër						
		Shkrel						
	SHKODËR	Ana Malit	02	Shkodër	Pallati i Sportit "Qazim Dervishi"			
		Bërdicë						
		Dajç						
		Gur i zi						
		Postrinë						
		Pult						
		Shosh						
		Rrethinat						
		Shalë, Shosh						
		Velipojë						
		Shkodër (zona QV 0235/00 deri 0245/00, zona QV 0269/00, zona QV 0279/00, zona QV 0280/00, zona QV 0282/00, zona QV 0284/00, zona QV 0286/00 deri 0297/00, dhe zona QV 0299/00 deri 0304/00)				03	Shkodër	Palestra e Shkollës "Shenjaze Juka"
		Shkodër (zona QV 0246/00 deri 0263/00, zona QV 0265/00 deri 0268/00, zona QV 0270/00, zona QV 0276/00, zona QV 0316/00, zona QV 0318/00, zona QV 0319/00 dhe zona QV 0321/00)				04	Shkodër	Palestra e Shkollës "Ismail Qemali"
		Shkodër (zona QV 0271/00 deri 0275/00, zona QV 0277/00, zona QV 0278/00, zona QV 0281/00, zona QV 0283/00, zona QV 0285/00, zona QV 0298/00, zona QV 0305/00 deri 0315/00, zona QV 0317/00, zona QV 0320/00, zona QV 0322/00 dhe zona QV 0323/00)				05	Shkodër	Palestra e Shkollës "Xheladin Fishta"
VALLE-DEIËS	Bushat	06	Bushat	Palestra e Shkollës së Mesme "Ndre Mjeda",				
	Hajmel, Vig Mnele							

Qarku	Bashkia	Njësia Administrative	ZAZ	Vendndodhja e Selisë ZAZ/Qendra e Njesisë Administrative	Selia e KZAZ-së 2023
Shkodër	Vau Dejës	Shllak	06	Bashkia	Palestra
		Vau Dejës, Temal			
	PUKË	Pukë, Rrapë	07	Pukë	Palestra e Shkollës së Mesme, Pukë
		Gjegjan			
Qerret, Qelëz					
FUSHË ARRËZ	Fierzë	08	Fushë Arrëz	Shkolla 9-vjecare "Pjeter Arbërori", palestra	
	Fushë Arrëz, Qafë Mali, Blerim				
	Iballë				
Kukës	TROPOJË	Bajram Curri	09	Bajram Curri	Muzeu Historik, Salla nr.I
		Bujan			
		Bytyc			
		Fierzë			
		Lekbibaj			
		Llugaj			
		Margegaj			
	Tropojë				
	HAS	Fajzë	10	Krumë	Zyra Arsimore Has, Salla Mbledhjeve
		Golaj			
Krumë, Gjinaj					
KUKËS	Bicaj, Ujmisht	11	Kukës	Pallati i Kulturës "Hasan Prishtina"	
	Bushtricë, Grykë Cajë, Kalis				
	Kukës, Kolsh				
	Malzi				
	Shishtavec				
	Shtiqen				
	Surroj, Arren				
	Tërthore				
	Topojan				
Zapod					
	Lezhë	12	Lezhë	Gjimnazi "Hydajet Lezha" Palestra	
	Ballëdren				
	Shëngjin				

Qarku	Bashkia	Njësia Administrative	ZAZ	Vendndodhja e Selisë ZAZ/Qendra e Njësisë Administrative	Selia e KZAZ-së 2023
Lezhë	LEZHË	Blinisht	13	Lezhë	Shkolla 9-vjeçare "Besëlidhja", Palestra
		Dajç			
		Kallmet			
		Kolsh			
		Shënkoll			
		Ungrej			
		Zejmen			
	MIRDITË	Fan	14	Rrëshen	Pallati i Kulturës
		Kthellë, Selitë			
		Orosh			
		Rrëshen, Kaçinar			
	Rubik				
KURBIN	Fushë Kuqe	15	Laç	Shkolla 9-vjeçare "Gjon Gjonaj", Salla e Mbledhjeve	
	Laç				
	Mamurras				
	Milot				
Tribër	MAT	Baz	16	Burrel	Pallati i Sportit "Ferit Hysa", Burrel
		Burrel			
		Derjan, Macukull			
		Komsi			
		Lis			
		Rukaj			
		Ulëz			
	KLOS	Gurrë	17	Klos	Biblioteka Klos
		Klos			
		Suç			
		Xibër			
	BULQIZË	Bulqizë	18	Bulqizë	
Fushë Bulqizë					
Gjoricë					
Martanesh					
Ostren, Klenjë					

Qarku	Bashkia	Njësia Administrative	ZAZ	Vendndodhja e Selisë ZAZ/Qendra e Njësisë Administrative	Selia e KZAZ-së 2023	
D		Shupenzë			Pallati i Kultures	
		Zerqan				
	DIBËR		Arras	19	Peshkopi	Qendra e Edukimit dhe Komunikimit (QEK)
			Fushë Çidhen			
			Fushë Muhur			
			Kala e Dodës			
			Kastriot			
			Lurë			
			Luzni			
			Maqellare			
			Melan			
			Peshkopi			
			Selishtë			
			Sllove			
	Tomin					
	Zall Dardhë, Zall Rec					
ës	KRUJË	Bubq	20	Krujë	Pallati i Kulturës, Krujë	
		Cudhi				
		Fushë Krujë				
		Kodër Thumanë				
		Krujë				
		Nikel				
			Ishëm	21	Sukth	Pallati i Sportit "Ramazan Njala"
			Katund i Ri			
			Manëz			
			Rashbull			
			Sukth			
		Durrës (zona QV 1408/00 deri 1424/00, zona QV 1458/00, zona QV 1459/00, zona QV 1463/00, zona QV 1467/00 deri 1470/00)	22	Durrës	Shkolla Marie Kaçulini	

Qarku	Bashkia	Njësia Administrative	ZAZ	Vendndodhja e Selisë ZAZ/Qendra e Njësisë Administrative	Selia e KZAZ-së 2023
Durrës	DURRËS	Durrës (zona QV 1429/00, zona QV 1433/00, zona QV 1443/00, zona QV 1444/00, zona QV 1446/00 deri 1451/00, zona QV 1461/00, zona QV 1462/00, zona QV 1471/00 deri 1482/00, zona QV 1484/00 deri 1494/00, zona QV1501/00 deri 1504/00)	23	Durrës	Shkolla e Muzikës "Jan Kukuzeli"
		Durrës (zona QV 1425/00 deri 1428/00, zona QV 1430/00 deri 1432/00, zona QV 1434/00 deri 1442/00, zona QV 1452/00 deri 1457/00, zona QV 1460/00, zona QV 1464/00, zona QV 1465/00, zona QV 1483/00 dhe zona QV 1495/00 deri 1500/00)	24	Durrës	Shkolla "Leonik Tomeo"
	SHIJAK	Shijak	25	Shijak	Gjimnazi "16 Shtatori", palestra
		Gjepalaj Maminas Xhafzotaj			
Tiranë	VORË	Vorë	26	Vorë	Shkolla 9-vjeçare Vorë
		Bërçull			
		Prezë			
	KAMËZ	Kamëz	27	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare "Hillary Clinton", klasë
		Paskuqan	28	Paskuqan	Gjimnazi "Isa Boletini", Paskuqan
	TIRANË	Baldushk	29	Tiranë	Biblioteka e Shkolles 9-vjeçare "Katund i Ri"
		Kashar			
		Ndroq			
		Petrelë			
		Pezë			
Vaqarr					
Berzhitë		30			
Dajt					
Farkë					
Krrabë					
Shëngjergj					
Zall-Bastar					
Zall-Herr					

Qarku	Bashkia	Njësia Administrative	ZAZ	Vendndodhja e Selisë ZAZ/Qendra e Njesisë Administrative	Selia e KZAZ-së 2023
Tiranë					
		Njësia Bashkiake Tiranë 1	31	Nj. Administrative nr. 1	Shkolla 9-vjecare "Kushtrimi i Lirise", klase
		Njësia Bashkiake Tiranë 2	32	Nj. Administrative nr. 2	Shkolla 9-vjecare "Hasan Tahsim", klase
		Njësia Bashkiake Tiranë 3	33	Nj. Administrative nr. 3	Shkolla e Mesme A.Z.Çajupi, salla e mesuesve
		Njësia Bashkiake Tiranë 4	34	Nj. Administrative nr. 4	Shkolla 9-vjeçare "Bajram Curri", zyre kabineti
		Njësia Bashkiake Tiranë 5	35	Nj. Administrative nr. 5	Shkolla 9-vjeçare "Vasil Shanto", zyre mbledhje
		Njësia Bashkiake Tiranë 6	36	Nj. Administrative nr. 6	Shkolla 9-vjeçare "Betim Muço", Kabinet
		Njësia Bashkiake Tiranë 7	37	Nj. Administrative nr. 7	Shkolla 9-vjeçare "Gustav Majer"
		Njësia Bashkiake Tiranë 8	38	Nj. Administrative nr. 8	Shkolla 9-vjeçare e Kuqe, Salla e psikologeve
		Njësia Bashkiake Tiranë 9	39	Nj. Administrative nr. 9	Muzeu Historik kombetar, Salla e mbledhjeve
		Njësia Bashkiake Tiranë 10	40	Nj. Administrative nr. 10	Shkolla e Mesme "Qemal Stafa", Klase
		Njësia Bashkiake Tiranë 11	41	Nj. Administrative nr. 11	Shkolla 9-vjeçare "Ahmet Gashi", Zyra e psikologut
	KAVAJË	Kavajë	42	Kavajë	Shkolla 26 Marsi, palestra
		Golem			
		Helmës			
		Luz i Vogël			
		Synej			
	RROGOZHINË	Rrogozhinë, Sinaballaj	43	Rrogozhinë	Gjimnazi Haxhi Qehaj, palestra
		Lekaj			
		Gosë			
		Kryevindh			
	PEQIN	Peqin, Karinë	44	Peqin	Pallati i Kulturës, Zyrë kati I, Lagja " Teqe"
		Gjocaj			
		Pajovë			
		Përparim			
		Shezë			
	BELSH	Belsh, Rrasë	45	Belsh	Palestra e Gjinnazit, Belsh
		Fierzë			
		Grekan			
		Kajan			
Elbasan	CËRRIK	Cërrik	46	Cërrik	Ish Kinoklubi "Ptoleme Xhuvani"
		Gostimë			
		Klos			
		Mollas			
		Shalës			

Qarku	Bashkia	Njësia Administrative	ZAZ	Vendndodhja e Selisë ZAZ/Qendra e Njësisë Administrative	Selia e KZAZ-së 2023
Elbasan	ELBASAN	Bradashesh, Gracen	47	Elbasan	Pallati i Sportit "Tomorr Sinani"
		Funarë			
		Gjergjan			
		Gjinar, Zavalinë			
		Labinot Fushë			
		Labinot Mal			
		Papër			
		Shirgjan			
		Shushicë			
		Tregan			
Elbasan	ELBASAN	Elbasan (zona QV 2300/00 deri 2323/00, zona QV 2327/00, zona QV 2328/00)	48	Elbasan	Pallati i Sportit "Tomorr Sinani"
		Elbasan (zona QV 2356/00 deri 2378/00)	49	Elbasan	Pallati i Sportit "Tomorr Sinani"
		Elbasan (zona QV 2329/00 deri 2355/00)	50	Elbasan	Pallati i Sportit "Tomorr Sinani"
	GRAMSH	Gramsh, Skënderbegas, Kushovë	51	Gramsh	Pallati i Kulturës, Salla e leximit
		Kodovjat, Lenie			
		Kukur			
		Pishaj, Sult, Poroçan			
	Tunjë				
	LIBRAZH	Librazhd, Stëblevë	52	Librazhd	Palestra e Shkolles se Mesme te Përgjithshme "Ibrahim Muça"
		Hotolisht			
Lunik					
Orenjë					
Polis					
Qendër-Librazhd					
PRRENJAS	Prrenjas	53	Prrenjas	Palestra e Shkolles Mesme "Halit Berzeshta" Prrenjas	
	Qukës				
	Rrajcë				
	Stravaj				
		Allkaj			
		Ballagat			
		Bubullimë			
		Dushk			

Qarku	Bashkia	Njësia Administrative	ZAZ	Vendndodhja e Selisë ZAZ/Qendra e Njësies Administrative	Selia e KZAZ-së 2023
Fier	LUSHNJË	Fier Shegan	54	Lushnjë	Palestra e Shkolles "Skender Libohova"
		Golem			
		Hysgjokaj			
		Karbunarë			
		Kolonjë			
		Krutje			
	Lushnjë	55	Lushnjë	Holli i Muzeut Historik, Lushnje	
	DIVJAKË	Divjakë	56	Divjakë	Qendra Kulturore Divjake
		Grabian			
		Gradishtë			
		Remas			
	Tërbuf				
	FIER	Cakran	57	Fier	Shkolla e Mesme Profesionale "Petro Sota"
		Frakull			
		Levan			
		Portëz			
Libofshë		58	Fier	Shkolla Artistike "Jakov Xoxa"	
Dërmenas					
Mbrostar					
Qëndër Fier					
Topojë					
Fier	59	Fier	Shkolla e Mesme e Përgjithshme "Janaq Kilica"		
PATOS	Patos	60	Patos	Pallati i Kulturës, salla e leximit	
	Ruzhdie				
	Zharrëz				
ROSKOVEC	Roskovec	61	Roskovec	Pallati i Kulturës, Roskovec	
	Kuman				
	Kurjan				
	Strum				
MALLAKASTËR	Ballsh	62	Ballsh	Shkolla Mesme "Dervish Hekali" Palestra, Ballsh	
	Aranitas, Ngracan				
	Fratar, Selite				
	Greshicë				
	Hekal				
	Kute				
Qendër Mallakastër					

Qarku	Bashkia	Njësia Administrative	ZAZ	Vendndodhja e Selisë ZAZ/Qendra e Njesisë Administrative	Selia e KZAZ-së 2023
Berat	URA VAJGURORE	Ura-Vajgurore	63	Ura Vajgurore	Kinemaja e Qytetit, Dimal
		Cukalat			
		Kutalli			
		Poshnje			
	KUÇOVË	Kuçovë	64	Kuçovë	Salla e Qendrës Kulturore e Fëmijëve
		Kozare			
		Lumas			
		Perondi			
	BERAT	Berat	65	Berat	Pallati i kulturës "Margarita Tutulani"
		Otlak	66	Berat	Biblioteka "Vexhi Buharaja"
		Roshnik			
		Sinjë			
		Velabisht			
	POLIÇAN	Poliçan	67	Poliçan	Pallati i Kultures, Zyrë kati II Lagja"Qendër"
Tërpan					
Vërtop					
SKRAPAR	Çorovodë	68	Çorovodë	Qendra Kulturore "Riza Cerova"	
	Bogovë, Vendresh				
	Çepan				
	Gjerbës, Zhepë				
	Potom				
	Qendër-Skrapar, Leshnje				
POGRADEC	Pogradec	69	Pogradec	Teatri i Kukllave "Piro Xëxi"	
	Buçimas				
	Çërravë				
	Dardhas				
	Udënisht				
	Proptisht				
	Trebinjë				
	Velçan				

Qarku	Bashkia	Njësia Administrative	ZAZ	Vendndodhja e Selisë ZAZ/Qendra e Njesisë Administrative	Selia e KZAZ-së 2023	
Korçë	MALIQ	Maliq	70	Maliq	Shkolla 9-vjeçare "Agimi", Bulevardi "Rinia"	
		Gorë				
		Moglicë				
		Libonik				
		Pirg				
		Pojan				
		Vreshtas				
	PUSTEC	Pustec	71	Pustec	Shkolla e Mesme Pustec	
	DEVOLL	Bilisht	Bilisht	72	Bilisht	Qendra Kulturore e Fëmijëve
			Hoçisht			
Miras						
Progër						
Qendër Bilisht						
KORÇË	Drenovë	Mollaj, Vithkuq	73	Korçë	Ish UMB, Inkubatori i Biznesit	
		Qendër Korçë				
		Voskop				
		Voskopojë, Moglicë, Lekaj				
		Korçë				
	Korçë	74	Korçë	Ish UMB, Inkubatori i Biznesit		
KOLONJË	Ersekë, Barmash	Leskovik, Leskovik	75	Ersekë	Biblioteka "Skënder Luarasi"	
		Qendër Ersekë, Novoselë				
		Mollas, Çlirim				
PËRMET	Përmet	Çarçovë	76	Përmet	Qendër e Fëmijëve me aftësi ndryshe	
		Petran				
		Qendër Përmet, Frashër				
KËLCYRË	Këlcyrë	Ballaban	77	Këlcyrë	Qendra Kulturore Multifunkionale	
		Dëshnicë				
		Sukë				

Qarku	Bashkia	Njësia Administrative	ZAZ	Vendndodhja e Selisë ZAZ/Qendra e Njësisë Administrative	Selia e KZAZ-së 2023
Gjirokastrë	MEMALIAJ	Memaliaj	78	Memaliaj	Pallati i Kulturës, Memaliaj
		Memaliaj Fshat			
		Krahëz, Qesarat			
		Luftinjë. Buz			
	TEPELENË	Tepelenë	79	Tepelenë	Qendra Kulturore, Tepelenë
		Qendër Tepelenë, Kurvelesh, Lopëz			
	GJIROKASTËR	Gjirokastrë	80	Gjirokastrë	Pallati i Sportit , Gjirokastrë
		Cepo, Picar			
Lazarat					
Lunxhëri, Odrie, Antigon					
LIBOHOVË	Libohovë, Qendër-Gjirokastrë, Zagori	81	Libohovë	Shtëpia e Kulturës, Libohovë	
DROPULL	Dropull i Poshtëm	82	Grapsh	Qendra e Kultures Grapsh	
	Dropull i Sipërm				
	Pogon				
VLORË	Orikum	83	Vlorë	Palestra e Shkolles "Ismail Qemali"	
	Novoselë				
	Qendër Vlorë				
	Shushicë				
	Vlorë (zona QV 4429/00 deri 4434/00, zona QV 4436/00 zona QV 4437/00, zona QV 4443/00, zona QV 4456/00-4459/00, zona QV 4494/00, zona QV 4495/00, zona QV 4499/00 deri 4506/00 dhe zona QV 4510/00)	84	Vlorë	Pallati i Kultures "Labëria"	
Vlorë (zona QV 4427/00, zona QV 4428/00, zona QV 4438/00 deri 4442/00, zona QV 4444/00 deri 4445/00, zona QV 4482/00 deri 4487/00, zona QV 4507/00 deri 4509/00)	85	Vlorë	Palestra e Shkolles Ali Demi		
Vlorë (zona QV 4460/00 deri 4481/00, zona QV 4488/00 deri 4493/00, zona QV 4496/00 deri 4498/00)	86	Vlorë	Pallati i Sportit Flamurtari		

Qarku	Bashkia	Njësia Administrative	ZAZ	Vendndodhja e Selisë ZAZ/Qendra e Njësisë Administrative	Selia e KZAZ-së 2023
Vlorë	SELENICË	Selenicë	87	Kotë	Palestra e Shkolles Kotë
		Armen			
		Brataj			
		Kotë			
		Sevaster			
	Vllahinë				
	HIMARË	Himarë	88	Himarë	Godina e fushës së sportit, Himarë
		Horë-Vranisht			
		Lukovë			
	DELVINË	Delvinë	89	Delvinë	Kinoteatri
Vergo					
SARANDË	Sarandë	90	Sarandë	Qendra Kulturore, Sarandë	
	Ksamil				
FINIQ	Aliko	91	Livadhja	Qendra Kulturore, Livadhja	
	Dhivër				
	Finiq				
	Livadhja				
Mesopotam					
KONISPOL	Konispol	92	Konispol	Palestra e Shkollës së Mesme "Bido Sejko"	
	Markat				
	Xarrë				